

V E N D I M
Nr.406, datë 31.8.1999

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.195, DATË
20.3.1998, “PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE QË NUK MUND TË
TRANSFORMOHEN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.195, datë 20.3.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”, në pikën 5 shtohet paragrafi i dytë: “Shitja mund të kryhet edhe me tender. Procedurat e tenderit dhe ndërmarrjet që do të shiten me tender përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko